XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Titulli :

Kënga e lotit (Poezi)

Autor:

Xhevahir Cirongu

Redaktor:

Adem Zaplluzha

Korrektor:

Mirela Gumeni (Cirongu)

Kopertina:

Aleksandër Lleshi (piktor)

Botues:

Botimet Jozef – Durrës, 2016

ISBN978 -9928 -189 -82- 0

Kënga e lotit

Poezi

Xhevahir Cirongu

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Thënie të formuluara nga autori

"***...Dituria*** i qëndron afër të paditurës. Ajo e mëson të paditurën si të rrugëtojë në jetë por.....!
Mirëpo, fatkeqësisht e paditura, ngaqë s'e kupton dot diturinë, e përbuz atë deri aty sa e lëndon gjer në skutat e shpirtit diturinë. Kështu,e paditura bie në greminë. Si rrjedhojë e kësaj, atëherë kujtohet dhe kërkon për të shpëtuar nga fatkeqsia, **Diturinë!**".
(Dhjetor 2014)

’’ Kur lindim derdhim ***lot gëzimi***, por edhe kur largohemi nga kjo botë, përsëri derdhim **lot hidhërimi**. Sa çudi me të vërtet!? Pse ndodh kështu, - pyesim ne!
Por ja, një përgjigje egziston:’’***Sepse nga loti kemi lindur e me lot ikim në parajsë drejt lumturisë së përjetshme...!’’***
(Dhjetor 2014)

*'' **Ilaçi*** më i mirë që shëron plagën e shpirtit në trupin tonë njerëzor, por edhe që forcon kockën dhe e bën më fosforishente atë, ***është diellësia e fjalës së mirë!''***
(Shkurt 2015)

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

TË LEXOSH LOTIN NË VARGJE

PËLLUMB GORICA

Ka shumë njerëz që kohën e lirë e shfrytëzojnë me mënyra të ndryshme. Xhevahir Cirongu është nga ata, që kredon e vet shpirtërore e shpalos në shkrime të sinqerta e të thjeshta. Ai me mënyrën e tij fotografon pjesë fragmentesh nga realiteti që jetojmë, duke nxjerrë nga korniza gjykimet e tij. Kjo për mendimin tim është një lloj vlere, që autori e shpalos herë pas herë me mjete të thjeshta, dhe me një gjuhë komunikuese e të ngrohtë, si shprehi të botës së ndjenjave shpirtërore.

Është për t'u theksuar se nga libri në libër ky autor vjen duke shpërfaqur gradualisht elementët, të cilët arrijnë të përformojnë profilin krijues të tij. Kjo krijimtari që vjen së brendshmi, prej ngacmimeve të vazhdueshme të shpirtit, të shoqëron si jehona e përrenjve të rrëmbyeshëm e ujëpastër të vendlindjes së tij, që teksa rrjedhin drejt detit përhapin freski, e mirësi jetëdhënëse. Xhevahiri përshkuan episode, portrete, dhimbje, tavolinat e gëzimeve, natyrën e papërsëritëshme me imtësi detajesh dhe ndjesi përjetuese. Nuk ka gjë më bukur se sa të lexosh krijime të tilla me plot pathos e përkushtim qytetar, ndjenja të sinqerta dhe besnike për dashurinë ndaj atdheut, dashurinë ndaj asaj që është në shërbim të së mirës për ruajtjen e vlerave e të trashëgimisë kulturore. Mënyrat me të cilën është

shprehur ai në shkrimet patriotike, janë të pashkëputur nga këndvështrimet pozitive për heronjtë e kohës, vlerat e mirëfillta, që më së shumti i shërben evidentimit të vlerave kombëtare, shoqërore, duke krijuar kështu një ndjenjë respekti për kohën që ndodhemi me vrulle jete, imagjinatë pasionesh dhe aftësinë krijuese për t'i shëndërruar në vepra artistike.

Të endesh, do të thotë të hysh në çdo skutë jete, dhe po ashtu, përtej imagjinatës të prekësh dritën. Xhevahir Cirongu endet në peizazhet e mrekullueshme për të na sjellë koloritin e pasur të ngjyrave e bukurive natyrore, të gërshetuar me shpirtin e ndjeshëm të tij, dhe gjithçka përmes një tematike e një gjuhe të pasur. Frymëzimin ai e kërkon si gjurmimi i mrekullueshëm i nje blete ndër lulet, si arkeologu që hulumton historinë për të konkluduar të vërtetën, te fijet e barit që vallëzojnë lehtë nga flladi i pranverës me aromë, në rendjen e ditëve, ku rrjedh gëzimi i shpirtit, te një lot i sinqertë si kristali apo edhe te një buzqeshje e ngrohtë. Me fjalën e tij poetike Xhevahir Cirongu, të bën të ndiesh thellë botën që jeton, prokupimet dhe mbrapshtitë jetësore. Aty zbulon optimizmin dhe qëndrimin e drejtë për njerëzit, ridimesionet përndritëse të përjetimeve. Kjo lloj ndjesie lexohet edhe në vëllimin poetik "*Kënga e lotit*", titull që mbart një peshë të veçantë metaforike. Ai ngjan më thellë, dhe nuk është vetëm këngë loti që tingëllon trishtueshëm, e s'është i zymtë në dhimbjen kur e poetizon atë në ndenja të pjestuara në vargje. Kënga e lotit të Xhevahir Cirongut ka ngjyra, aroma,

mendime dhe ajër që vibron hollë e estetikisht, sepse një libër poetic është një univers i tërë shpirtëror. Elementët që e popullojnë atë si era, qielli, dielli, retë, shiu, deti, valët, shkëmbi, gjethja, petalet etj shprehin ndenja, duke përcjell te lexuesi mesazhe të qarta.

Në vëllimin poetik "*Kënga e lotit*", tematika që rrok në këto krijime autori, është e gjërë, dhe nëpërmjet sensit lirik malli frymon me psherëtimat, si një lajmotiv i brendshëm. Këtë gjë e ndjen më shumë në poezinë e tij burimore, ku ai kërkon të gremisë gurët e rëndë të mallit, të gërmojë në dhimbjet, të ndalojë shiun, të magjepset pas hënës. Përmbi gjithçka triumfon dashuria për nënën, e para saj çdo gjë bëhet e pavlerë. Ndaj shpirtin e shkrin nga kjo dashuri e pamatë. "*Nënën kërkon çdo ditë në thërmija dheu/ Kaluanë vitet e loti u bë ar / Me dashuri puthi yllin në qiell/ Se ai si nëna i ngjau*.'' Vendlindja është muza për çdo autor, e çfarëdo lloji profile qoftë ai. Ajo zbukuron shpirtin poetik, të Xhevahir Cirongut me emocione, jetën dhe dashurinë për të, dhe nuk është vetëm fjalë, por një ndenjë sa vetë jeta mbi tokë, e sidomos drithërimë malli kur është larg, të cilën ai e sjellë më të ngrohtë. " *Malli i vendlindjes/ qënka zhur e prush/ ajo këngë e bukur/ gjoksin plot ta mbush*." I lexon kujtimet që shkojnë larg me rrënjë të shtrira përtej ekzistencës tokësore, ndaj ai portën e tyre e mban hapur të përhumbet në to. "*Nën hijen e degëve të lisit, gjethet numërova/ Nga flladi i erës u shkundën, supeve më ranë/ Eca i vetmuar, rrugës së kujtimeve s'u ndala/ Pse u trembën gjethet, në ç'yll ata ndaluan!?*".

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Por autori ''*ecën kalëruar mbi vitet e jetës*", të "*puth me vrap*"stinët me butësinë e vargut, që s'është vetëm margaritar ndenjash."*Shiu i pranverës butësishtë ra ngadalë/ Nga qielli u derdhën një nga një luleloti / Shtëllunga resh të çara si me daltë/ Ndaluan trishtimin atje te shkëmbi.*" Loti i bën poezitë e Xhevahir Cirongut të flasë shumë me lexuesin, të ndjej "*valsin e këngës*", të kolovitet në ëndërrat, të "*hap krahët... ta prekësh*", të gëzoj me shkëlqimin se "*brenda tyre lexon vetëm jetë*.'' Loti brengoset dhe''*sa dhimbje ndjen në zemër*" kur e lag ombrellën hije ulliri. Ai ushqehet me ndjenja të pastra, me dashurinë për tokën, për mungesën e atyre që i duam, të shtrirë në kohë dashurish, e të strukura në heshtje. "*Në heshtje mes lotëve/ dëgjohej zëri i saj që këndonte/ valsin e këngës./ Heshtje, heshtje, heshtje!/ Vetëm tingujt e kitarës dëgjoheshin.*" Humanizmi shpirtëror s'ka përkufizim për njeriun, dhe pse në zbehje, që në një mënyrë a në një tjetër e gjejmë në vargjet e Xhevahir Cirongut, kur i thur ato për poetët, miqtë, heronjtë me vlersimin që buron nga zemra, e lartësohet në vërtetësi. "*Zhurmon Osumi nga ujërat nëpër luginë/ Dhe valët e bardha i ndal atje mbi shkëmb/ Vargu i poetit zgjuar rri tek unë/ Pse s'flet poeti? Ah! Nga ky çast gjoksi po më dhemb!*".

Dashuria është nocion shumë i gjerë, dhe këtë poeti e konkretizon sipas asaj që ndjen në zemër,

sidomos ndjenjën që buron natyrshëm. Kjo e ka bërë të pazëvendësueshme këtë ndjenjë madhore: "*Në heshtje takon dashurinë/ Që fshehur qëndron diku/ Ashtu vjen një ditë, si lind i shkreti njeri/ Ecën kalëruar mbi vitet e jetës/ Dhuke shkundur petalet e viteve/ Dhe s'u vë dot fre*."

Në qoftë se një pranverë zbukurohet edhe kur "*çelin lulet përmbi shkëmb*", poezinë e Xhevahir Cirongut e kanë zbukuruar atë me metaforat dhe figurat letrare të gjetura, të cilat ledhatohen rreth foljes për të treguar mjeshtërisht emocionin që tek lexuesi është i thellë dhe i gjërë.

Në fund mund të themi se: "*Këngë loti*" është një botë plot elegancë, mirësi, muzikalitet, por edhe me nota shpirti të ndërthurura nga krijuesi, Xhevahir Cirongu.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Në rrugicën e lagjes

Në lagjen time është një rrugicë
Anash saj është shtëpia ime,
Sa herë që mbi atë s'kalon njeri
E shoh të trishtuar e të plakur,
por edhe të heshtur.
Kur kaloj mbi gurë të shtruar kalldrëm
I ndjej hapat e mi që trokasin mbi gurë,
Pa dashur ajo bëhet e gëzuar, e qeshur
Sepse mbi gurët e saj hodha hapin e parë.
Edhe unë jam plakur me thinja të bardha në kokë
Më kujtohen moshatarët kur luanim në rrugicë;
Aty te ata gurë të lëmuar nga hapat tanë
Kur ishim fëmijë pa dashur gjunjët edhe kemi vrarë.
Kanë kaluar shumë vite e të freskëta ruaj kujtime
Diku mbi gurët e rrugicës ka ende gjak të tharë,
Në shpirtin tim gurët ndriçojnë si yje
Prandaj, ata gurë të rrugicës sime si kam sharë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Letër nënës

Malli për ty o nënë më ka marrë
Për sytë e tu plot dritë e çiltërsi,
Për gjoksin tënd të ngrohtë si zjarr
Aty ku mbështeta kokën kur isha fëmi.

..Dhe për flokët e thinjur më ka marrë malli
E për ledhatimet e ngrohta me ato duar,
Ah!Rrudhat e thelluara nga vitet mes ballit
O nënë, njëri pas tjetërit ty t'i kanë shtuar.

Malli im o nënë është prej refugjati
As thuhet me fjalë,as shuhet s'shkruari në letër;
Dhe zemra ime hapet si brazë ugari
Atëherë zë e nis për ty një mall tjetër.

Dhe malli im tretet në vetvete
E shtohet për ty pa pushim,
Ah s'të thashë dot të ëmblën fjalë
Kur po mbushje ujë te pusi i shtëpisë.

Do vij s'shpejti o shtrenjta ime nënë
Të puth gurët e dheun e vendlindjes sime,
Le të tretet malli si kripa e detit në valë
Lotët e dhimbjes do ti dërgoj atje nën dhe.

Shi në qytetin tim

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Mbi kodrën e qytetit tim
Si pulëbardha retë zbresin atje,
Në dallgët e detit lënë puthjet
Dhe lotin e qiellit te një ulli.

Atje në tapetin e gjelbër diku
Këmbëkryq ulem e pi vesën,
Ndërsa nëpër degët e pemëve
Qëndrojnë varur retë e yjet.

Pse u larguan yjet e retë
Mos i tremba unë ato!?
Nëpër kaltërsinë qiellore
Nxitojnë që të marrin ,
një grusht ujë për të shuar etjen.

Herët në mëngjes atë ditë gri
Filloi të lotojë syri i kaltër vjeshtak.
Pas kësaj, ashtu në fshehtësi
U lanë muret e kalasë së lashtë.

Ndaloj e vështrimin hedh në horizont
Pas shiut një fjongo ylberi ullishten vesh,
Unë, s’bashku me njerëzit e qytetit tim
Bisedojmë me valët e bardha të detit.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

I putha gjethet e vjeshtës

Erdhi vjeshta me ngjyrat e saj
peizazhi i gjetheve,
nëpër degët e pemëve
në gji zjarre ndezur mban.
…Kurse dielli i përflakur vjeshtak
nga syri i zjarrtë në perëndim,
ngadalë mbi kolorin e gjetheve
lë ngrohtësi,
pastaj, nën zë me to kuvendon.
Degët lakuriqe të një peme
qanin në vetminë e pyllit,
kolori i gjetheve të viteve
qe tretur së bashku me gjethet.
Pse u venitët,
ju gjethe të gjelbra?!
Aty mbi trung,
në degët e thata
këngën e vajit latë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

As këngën bilbilat
më aty s'e këndojnë,
sa herë ata kthehen
te dega e thatë,
flatrat e krahëve shkundin
si për t'i thënë lamtumirë.
Pas kësaj
në ditën gri të vjeshtës,
edhe unë vrapove te pema e thatë
te shelgu lotues degëvarur,
një gjethe vjeshte kolori
e putha me vrap.
Durrës, 28 shtator 2013

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Unë flas me plepin

Te plepi dikur kam bërë gjumin e fëmijërisë
Dhe zogjtë në foletë atje nëpër degë,
Meloditë e këngëve i derdhën mbi mua
Së bashku me flladin e pjalmit të erës.

Ashtu, pa kuptuar vitet vraponin
Zhurmimi i gjetheve iso u mbante,
Nëpër gjumin ëmbëltor ëndrrat zgjonin
Enigmën e jetës që askush se dinte.

I mblodha vitet në shportën e qershive
Një nga një nën hijen e plepit i numërova,
Lëvorja e plepit pa dashur ishte plakur
Lot i dylltë i ditëve nën gjethe rrinin të fshehura.

Intervista e jetës do zverdhet si limon
Dhimbja një ditë vjen e do bëhet gur,
Pas kësaj, kuçedra vdekje të gjitha i helmon
Kurse nesër një plep i ri do u flasë
Atëherë ju lexoni epitafin e do heshtni.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Poetit Adem Zaplluzha

Takohem te vargu yt
Aty të një mendim,
Pastaj,… vargu shkrihet
dhe trupi im bëhet një,
Aty me trupin e atdheut tim.

Durrës, Shtator 2013

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Emri yt flamur mbi re

(*Kjo poemth i kushtohet dëshmorit Jashar Jashari, birit të fshatit Strofc-Vushtrri, me rastin e 5 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës)*

1. Strofci ynë ka lind shqiponja
Vargje shkrova për historinë,
Stërgjysh- babë edhe nëna
Për lavdinë sot këndohet kënga.

2. Në do kombin e Shqipërinë
Por dhe nderin e flamurë,
Që të shkruash emrin te guri
Edhe gjakun derdh për Atdhe
Bir i Strofcit Jashar Jashari
Emri yt flamur mbi re!

3. Moj Kosovë si dritë e hënës
100 vjet sundoj Serbia,
Qysh nga koha e lashtësisë
Ke folur veç gjuhën e nënës.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

4. Për mbi varr të Halit Gecit
Grushtin lart ngriti ‘’Duraku’’,
Meteorët bënë betimin
Te beteja e Hamidisë
Hapën flatrat e lirisë.

5. Drejt shqipes erdhën kosovarë
Lotët në sy mbetën të tharë,
Qindra djem e vajza si luanë
Me shkaun ata luftuan.

6. Ishte dita e 14 marsit
E vitit ’99-të;
Në Livadhet e Qershisë
Mbi shkëmb çeli lulja e lirisë.

7. U vranë pleq, u ther fëmija
Ngjarja tundi gjithë planetin,
Lokja nënë kështjellë mbeti
Nëpër breza, deri sot
Kurrë gjakun të mos e shkelni
Betohuni te i madhi Zot!

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

8. Neve jemi evropianë
Amerika na u ndodh pranë,
Ndal masakrën moj Serbi
Se këtu i thonë Shqipëri.

9. U nxi qielli e u dridh toka
Bijtë e tu Strafcok luftojnë,
U skuq me gjak edhe shkëmbi.
Jep kushtrimin Jashar Jashari
‘’ U thotë trimave luftoni
Pozicionet mos lëshoni!’’.

10. Por një plumb i mallkuar
Trimin e qëllon te trupi,
Syri i shkëlqeu si çika
Lindur- rritur në ato gryka.

11. Nënës seç i çunë fjalë
Në betejë djalin kanë vrarë,
‘’Mos ma thoni këtë fjalë
Për lirinë e Kosovës
Djemtë rrojnë- i kemi gjallë!’’

12. Tufa lulesh karafili
Në gjoks nëna djemve u vuri,
Dhe lotët ndaluan mbi faqe
Shpirti tyre sot prehet në paqe.

13. Te Kosova është krenaria
Gjaku i tyre s'ka të tharë kurrë,
Në do kombin e flamur
Për mbi gur gdhendur LIRIA
Në shekuj rron PAVARESIA!

Durrës, 27 Janar 2014.

Puthjet e gjyshes ylberedrite

Ah, sa mall kam për gjyshen time
Kanë kaluar shumë vite,zërin s'ja dëgjoj,
Më thoni pra, ku ndodhet ajo mysafire
Në ç'planet sekret duhet ta kërkoj?!

Në gjunjë u ula e putha qemerin e portës
Buzët mbi gur etjen e mallit aty shuan,
Si dikur i thirra me gjysmë zëri gjyshe Fatimes
Nga qielli si hije zbriti portreti i saj
Më kapi për dore e më puthi ngadalë.

Eja më tha nipi im të përqafoj fortë
Mos vallë isha në ëndërr, syri gjyshes lotoi,
Atje te gurët e portës së shtëpisë së vjetër
Oshtima e ujërave të përroit Raven e Selgjin
Kujtimet e vjetra , ato m'i rizgjoi.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Fjongo ylbere malli u derdhën mbi mua
Thinja të bardha mbi kokë,valë ujë krua
Si ylberedrite gjyshja ka lënë puthjet.

Në kopshtin e zemrës time, e shtrenjta gjyshe
Lulet e dashurisë njerëzore në shpirt mi mbolli,
Gjurmët e viteve u tretën ashtu si bora.
Ah, s'ju vure atyre dot fre,
S'bashku me mallin e dhimbjes te yjet
Lulet e lotin dhuratë t'i çova atje nën dhe.

Durrës, 13 maj 2014

Pengu i lotit

Shiu i pranverës butësishtë ra ngadalë
Nga qielli u derdhën një nga një luleloti,
Shtëllunga resh të çara si me daltë
Ndaluan trishtimin atje te shkëmbi.
Dhe nata ra të flejë në gjumin e sajë
Jorgan hodhi mbi vete retë e bardha,
Lartë në qiell yjet tirrnin fjalë
Te shtrati i gjumit tregohej veç përrallë.
Dalngadalë u thërrmuan vitet nga ai shkëmb
S' bashku të dy ecëm nëpër kohën
Një çast ndaloi shiu te plaga që dhëmb
Kurse xixëllonja bënte dritë te lastari i hardhisë.
Në shtratin e gjumit tek të dy erdhën
Vitet e jetës me thinja kujtimesh malli,
U zgjuan ëndrrat të bardha pëllumbi fluturuan
Ndërsa yjet e këputura pengun e lotit lanë.

Durrës, 01 Maj 2014

Në folenë e dritës hënë

Nën hijen e hënës
Ëndrrat vrapuan për te ty vendlindje,
Pastaj, një çast aty ndaluan
E takuan Netën, Rovenën e motrën Xheni.
Një zog pëllumbi, nga retë zbriti
Me emrin Riklajdo, vëlla na erdhe,
Dhe drita e hënës ngjyrë floriri
Në zemrat tona u derdhën lumenj gëzimi!
Dhe engjëlli me flokë gështenjë
Tunjatjeta na përshëndet çdo ditë,
Në kullë të shpirtit të motrave
Fluturon Xixëllonja – dritë,
Me ty vëlla, vallëzojmë çdo ditë.
Këngën në djep të këndoi Nerënxa
Dhe puthjet e flladit të erës,
Nina- nina- Niati dhuroi

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Së bashku me dritën e hënës.
Pastaj, këngët e zanava ndaluan,
E puthjet çelën në gush zambak
Te Riklajdo aty qëndruan..
Sa herë prekim ballin tënd
Dhe puthjet lëmë te liqenet e kaftë,
Aroma e vendlindjes – Leskovë
Fushës në Vranisht takon
E përqafohet me erën e malit të Thatë.
Në folenë e dritës hënë
Miliona yje atje vezullojnë,
Mbi gjethet e akullta të reve
S' bashku me netët e janarëve
Në gjokse mburojë- jorgani
Të qeta gëzimet aty flenë.

Durrës, tetor 2013

Në udhëkryqe semaforët ndezur

I vetmuar eci në rrugën e jetës gri
Nëpër shtigjet e pashkelura kërkova diçka,
Atje, te ai lis shekullor fjalët qëndisë
Me fjongodrite shkruaji,dikush më tha.

Nën hijen e degëve të lisit,gjethet numërova
Nga flladi i erës u shkundën, supeve më ranë,
Eca i vetmuar, rrugës së kujtimeve s'u ndala
Pse u trembën gjethet, në ç'yll ata ndaluan!?

Dhe shirat e viteve, u derdhën mbi mua
Gjethet e lisit ranë si yje në shportën hënë,
Atëherë kuptova se jeta vërtet qënka si liman
Le të fryjnë erërat e kohërave, ato i putha
deri në rrënjë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Pluhuri i kohëve, shkruar nëpër epitafe
Te emri nënë, puthjet la drita-hënë,
Statujat e vdekjes era i shtyn deri te yjet
Dhe unë në heshtje gdhenda veç fjalë.

Kohët në udhëkryqe, semaforë ndezur
Vështrimin treta tutje atje te ajo kodër,
Lisi shekullor në trung çfarë mban fshehur!?
Hënën mban supit, dritë ari larë.

Qërshor, 20.06. 2014

Kënga e lotit

(Këtë poezi ia kushtoj mbretëreshës së këngës shqiptare, Artistes së Popullit Vaçe Zela)

Lotët e shkurtit u derdhën mbi arkivol
dhe yjet zbritën nga qielli
duke e përqafuar.Në heshtje mes lotëve
dëgjohej zëri i saj që këndonte
valsin e këngës.
Heshtje, heshtje, heshtje!
Vetëm tingujt e kitarës dëgjoheshin.
Pranë arkivolit të Vaçes
Shqiponja kishte hapur krahët për të fluturuar.
Në sytë e saj lexova fjalën - Atdhe!
Dhe plisi i dheut shkroi me germa të arta Vaçe!
Pastaj, këndoi valsin e këngës të Vaçes.
E dëgjoj mbretëresha e këngës shqiptare
S' bashku me yjet në qiell ndaloi mbi re,
Atje me yjet
Në përjetësi do këndojë këngët e atdheut.
Edhe unë këndova për Vaçen
Mbi arkivol këngën e lotit.

Shkurt, 06.02. 2014.

Kush tha se vdes dashuria

I hapa portat e shpirtit tim
Dhe flladi i erës pjalmin
Të luleve derdhi aty.
Dallgëve të detit çdo ditë u buzëqesh,
Me mallin e zambakëve të bardhë
Në heshtje takon dashurinë
Që fshehur qëndron diku.
Ashtu vjen një ditë, si lind i shkreti njeri,
Ecën kalëruar mbi vitet e jetës
Duke shkundur petalet e viteve

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Dhe s'u më dot fre.
Ah, kjo vdekja jonë si lakuriq i natës
Te shpirti ynë ajo fle.
Ikën- ikën e tretet materia e trupit tonë,
Dhe pas si shenjë gurin e lë atë mbi dhe.
Unë s'flas dot se isha aty nën tokë,
Por e pash ndjenjën e dashurisë
Ajo s'kishte vdekur!
S'ishte e vërtetë ashtu si më thanë
Te gonxhet e luleve të prillit
Me diellin e vesën putheshim
Unë e dashuria ishim gjallë.

Durrës, 03. Mars 2014

Sytë e kaltërsive

Sytë e asaj vajze janë të kaltër
Dhe brenda tyre lexon vetëm jetë,
T'i kisha dhe unë, jo për hatër
Sa çudi do të ishte me të vërtet!

Vrapova rreth botës si Magelan
Askund s'gjeta të tillë sy të kaltër,
Aty mes malesh si jargavan
Dy vajza e djali rrinë sy hapur.

Njëra vajzë e ka emrin Lurë
Dhe tjetra emrin Prespë e ka,
Ujëra rrjedhin nën akull e borë
Tek sy kaltra vallëzon veç zambak.

Dhe djali mes pulëbardhave-Ohri
Shtegton nga Korabi në Mal të Thatë,
Takon motrën Lurë e Prespë me dashuri
Kështu janë vendet e mija:vërtet si mjaltë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Fyelli i Çobanit

Aty nën gunë fyellin ai mban
Si një klloçkë me zogj e cicërima,
Zgjohen atëherë kur puthin buzët
Fryma merr jetë kur lëvizin gishtat
mbi brimat e hekurit të ftohtë.

Gunën e dhirtë çobani krahëve hedhur
Fyellin përkëdhel i ulur tek ai gur,
Tingujt oshtijnë grykës tutje derdhur
E ëmbla melodi monopatit gjithë nur.

Dhe këngën zogjtë e pyllit ndaluan atë çast
Melodinë e fyellit me ëndje dëgjuan,
Bisqet e barit po mbinin në tokën e zbraztë
Prapë valsin e këngës zogjtë kënduan
dhe me melodinë e fyellit u bashkuan.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Shi vjeshte

Mjegulla kish' rënë supeve të maleve
Në gjethet e pemëve pigmenti i vesë qante,
Te porta e hekurt ndalonin gjethet e vjeshtës
Era lozonjare i përkëdhelte me duart e ashpra.

Qielli i vjeshtës kishte veshur gunën e zezë
Dhe retë ishin të grisura si një çarçaf i vjetër,
As vetë nuk di se ç'kërkova atë natë
Veç shirat e vjeshtës , pikëllimin lanë aty në parmak.

Atje në mjegullën e bardhë pash lot nusesh
Vallen e gëzimeve qëndisnin me mëndafsh,
Me ngjyra buzëkuqesh nusesh mollët varur në degë
Flakëndezura - shami në oborr vallen kërcente.

Në frytin e shegës nata ra të flinte
Dhe unë me yjet tek porta i përgjumur prita,
Shiu i vjeshtës ngadalë m'u derdhën në supe
Hëna dritë argjend më tha : '' fli i qetë me mua.!''

Rritet një pulëbardhë

Që kur u krijua bota
dhimbja na ka ndjekur
si njerëzit, e gjallesat e tjera;
sa dhimbje ndjen në zemër?
kur rritet një pulëbardhë?!
zogjtë e saj të vegjël
pa nënë, si rriten vallë!...
Sa keq të vjen vërtet
për një lypsar të mjerë;
në një cep të rrugës
krahët shtrin për mëshirë...!

Alfabeti i gjuhës shqipe

E bukur gjuha jonë
fjalën e parë
ma mësoi nëna;
si tinguj violine
tingëllojnë 36 shkronja.
Në zgjoin e bletës
mjalti i shkronjave
rri brenda.

E bukur kënga Çame

Të këndojmë për Shqipërinë
Fjalët nga shpirti na vijnë,
E lartësohen në Tomorr
Lule – thurur bërë kurorë.

Ndriçojnë yjet për mbi male
Fustanella dridhet në valle,
Dhe gjëmon atje në hone
E bukur kjo kënga Çame.

Si gjerdan ngjeshur në breza
Nga Filati e Gumenicë,
Toka Çame do të mbetet
Në gjirin e historisë.

Janar, 2009

Fjalët e planetit

E kujtoj me mall
mësuesen e parë
vitet,një nga një
u zbrazën;
e prapë për të
kam shumë mall.
Ajo,dallëndyshe
unë zog i saj;
fjalët e planetit
m'i mësoj me radhë!...

Mall i zhuritur

Me prindërit shkova
në fshatin Leskovë,
ballin ma freskoi era
rrugës çelur lule borë.

I kthjelltë zëri
kënga vjen në gojë,
uji i vendlindjes
mjaltë e dyllë rojë.

Malli i vendlindjes
qenka zhur e prush,
ajo këngë e bukur
gjoksin plot ta mbush.

Leskovë, gusht 2007

Kthehu

Një ëndërr gjumin ta trazoi
dhe lulja që le në ballkon;
Kanarina që shumë të donte
për ty nuk po këndon.

Ëndrra prapë gjumin ta trazoi
djali që doje tek stoli po pret;
hap krahët... ta prekësh
jo...zemër, prej tij s'të ndan as deti.

Kthehu të thërret zemra
dhe lulja që le në ballkon,
Kanarina rri e mërzitur
për ty ndaj s' po këndon.

Durrës, qërshor 2008

Nën tinguj takash

E di që nesër do të ikësh
Gjithçka që thyhet s'ngjitet më,
Nga trotuaret pëshpëritës
Një mall i ngrirë do qajë a zë.

Gjithçka do shuhet pa kuptuar
Takimet,puthjet nën hënë,
Në stolin tonë të ërmallur
Të tjerë dashnorë vendin dozën.

S'do shfaqesh më si shtojzovalle
Nën tinguj takash plot kumbim,
Çdo dashuri i ngjan një përralle
Që ka një fund dhe një fillim.

E di që nesër ti do të ikësh
Unë s'kam forcë të të pyes,
Për ty jam si ky park bosh
E kur e sheh, të ngjall trishtim.

O baba Tahir të erdha

Frynte era që nga mali
Një zot erdhi që nga qielli,
Në Kuç,pranë lumit qëndroi
Tek tyrbja, Baba Tahirin nderoi.

Çohu o baba Tahiri
Të shikosh njerëzinë,
Po qajnë hallet me ty
Tuf-tufa, trëndelinë.

I madhi Zot të dërgoi
E të dha gjithë fuqinë,
Rrinë në gjunjë e të nderojnë
Myslimanë e Bektashinj.

Zemër zjarr si nga hera
O BABA TAHIR të erdha,
Këngë për ty sot këndova
Për mbi varr-lule të derdha.

Bisedë me detin

Me detin u rrita, shumë u miqësova
dhe pas teje o det,shumë u dashurova,
s'harrohen orët që pranë teje kaloja
dhe çdo shqetësim, ty ti tregoja.

Dallgët e t'ua shikoja i dëshpëruar
një çast nga bota me ty për të jetuar,
s'e veç ti qetësinë, mua ma kthen
hallet e mia,pa druajtje veç ty ti them.

Dëshirë nuk kam,që nga ty të largohem
kurrë dëshirë nuk kisha që të harroj,
sot, larg prej teje unë jam
tjetër dëshirë në zemër nuk kam.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Veç në brigjet e tua edhe një herë të jem
pastaj në brigjet e tua,
po vdiqa s' më ngelet peng;

kur jam me ty, ndihem i qetësuar,
sa herë hallet e mia
veç ti m'i ke larguar.

Durrës, korrik 2005

Shpirti më foli

Më kot prisja
Të më thërrisje nga pas,
Po ikja pa shpresë.....

Dhe gurët e rrugës
Fillova t'i godas,
Dhe ecja pa kujdes.

E shpirti më foli
Zemra diçka më tha,
Dy fjalë do të thosha unë...

Se në të gjithë botën
Që Zoti krijoi,
Ty të doja më shumë.

Bukuri paska kjo jetë

(Mars - prill ”97)

Pëllumba e dallëndyshet
Rritur si lulet në ves,
Lotët mbaji more baba
Se gjyshja mazi na ka.

S’ka më krisma edhe plumba
Tre yje zbritën nga retë,
U rritën si pëllumba
Ninulla tundur në djep.

Çeli lulja buzë prilli
Mblodhi lotët që kisha derdhur;
Zemra rri tek burimi
Jeta ime e pa tretur.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Me tre vajza e një kësmet
Ç'bukuri paska kjo jetë,
Shpirti-zemra të bashkuar
Katër yje të pashuar.

Nëna-nëna, - nëna ime
E ngroh fjala,- zemrën time,
Rreze dielli që gris retë
Prapë të erdha në këtë jetë.

Kur trokasin stinët

Zogjtë po shtegtojnë
Iku dhe një stinë,
Ujërat që vërshojnë
Kanë nisur të ngrijnë.

Stinët zbresin një nga një
Akull – borë e luleshumë,
Çelin lulet për mbi shkëmb
E ngrohin shpirtin fëmijëror .

Vjeshta me gjethe të verdha
Dimri vendin zbardh me borë,
Pranvera ka lule shumë
Vera ngroh shpirtin tek unë.

Kështu stinët janë,o fëmijë
Si anije nëpër det,
Udhëtojnë për tek ne
Nga ato marrim jetë.

Fluturo o ëndrra ime

Fluturo, o ëndrra ime
Shko e fli në shtratin tim,
Puth sykaltrën që fle gjumë
Dhe pastaj...ik nga unë!

Shko ngadalë e më zgjo
Në sy fut kaltërsinë,
Dhe mos rri e trishtuar
Ëndrrat kthemi si ujëvarë.

Ëndrrat fëmijërore
Fluturojnë në qiell,
Gëzimet e tyre
Në kraharor flenë.

Flutura, o ëndrra ime
Dhe sykaltrën t'i e zgjo,
Luledrite,plot me ngjyra
Kur më flet, na qesh fytyra.

Lule çelur Durrësi im

Vjen një dallgë e kaltër
E më buzëqesh,
Durrësi im i dashur
Madhështor si mbret.

Dielli ulet brenda meje
Një zgalem më flet ngadalë,
Sytë m'i mbush me dritë rrufeje
Dallgët ngrihen lartë si mal.

Muzgjet treten për mbi brigje
Zëri yt pa mbarim,
Mbi beden dhe mbi pirgje
Emri të ka plot kumbim.

Në dritare çel pranvera
Zemra hapur – dashuri,
Dera jote por si zemra
Hapur rri për çdo njeri.

Një çast takimi….

Spiranca e fjalëve supeve është hedhur
Si gjethet e vjeshtës ato rrugës ngelur,
Në qiellin e kaltër, dashuritë derdhur
Fushës shpirtërore farë lulesh mbjellë.

Mbi qerpikë të syve, vesa kishte rënë
Dashuri e shpirtit, puthur bashkë me hënë,
Sa dhe rrjedhë e fjalës, ka edhe rrënjë
Si një pemë magjike, ajo quhet Nënë!

Ndal një çast takimi, nënë e bijë qafuar
Mbesat shikim tretur, mbi qerpik- krua,
Asia edhe Sara, këtë emër kanë
Si kokrrat e rrushit, puthjet ato lanë.

Gjyshin edhe gjyshen ato përqafuan
Në dorë të vogla, zjarr i dhimbjes shuar,
Ti moj kullë e Pizës, mos rri e trishtuar
Dashuri e zemrës në fole rri zgjuar!...

Muzgjeve të mbrëmjeve....

Zgjata krahët drejt folezës aty në degë
Dhe zogjtë sqepverdhë i preka me dorë,
Nën dritën e hënës poshtë atij plepi,
Zogjtë dhe hëna, puthjet e të dshuruarëve
kanë numëruar....

Rrezet e argjendta të diellit në perëndim
Muzgjeve të mbrëmjeve,përhumbën në shtegtim;
Tufa zogjsh nëpër degët e plepit,dëgjon kumbim
Nën zhurmën e gëzimeve, dashuritë marrin fluturim.

Pemët në kopshte shkundin gjethet e verdha
Cicërimat e zogjve në fole më nuk i dëgjon,
Dhe unë e ndjej dhimbjen porsi vjeshta
Folezat e zbrazura i tremben errësirës nga vdekja.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Shtegtojnë zogjtë nëpër kontinente
Ata do kthehen tek plepi përsëri,
Nën dritën e hënës pranverore
Tek kënga e jetës do derdhin dashuri.

Dhe vjeshta gri të ngjall trishtim
Foletë e dallëndysheve i mbuloi heshtja,
Në vend të shpendëve , në qiell ka re
Bashkë me gjethet e verdha dhe unë ecja….

Poet i pathyeshëm

(Poetit , Xhevahir Spahiu)

Zhurmon Osumi nga ujërat nëpër luginë
Dhe valët e bardha i ndal atje mbi shkëmb,
Vargu i poetit zgjuar rri tek unë
Pse s'flet poeti? Ah! Nga ky çast gjoksi po më dhemb!....

Si kreshtat e maleve në vargje ai qëndron
Nëpër fletëza guri të bardha i shkrojë,
Kaltërsitë tomorriane, pastaj në to mbolli
Nga ky çast, vargu i shkruar dhimbjen i ndaloj.

Mbrëmjes plot vezullime dritash adriatikase
Aty buzë detit takohem me poetin,
Nga syri gjysmëhënë rrjedhin pika vese
Tunjatjeta do ti themi Xhevahir Spahiut
me qindra mëngjeseve……
S'ndahem dot nga poeti, vargu aty qëndroi

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Pavdekësinë e fjalës me rima e shkroi,
Ah, kjo plagë e dhimbjes, ç'bën aty ti?
Me vesë të mëngjeseve , lagi ata sy!

Dhe ti i jep dritë, si gurë meteori
Poet i pa thyeshëm, si një shkëmb tomorri;
Fjalët poetike në libra i mbolli
Perëndeshë e dijes që nga aty doli.

Për ''Baba Tomorrin'' varg thuri Çajupi
Dhe poet Xhevua i thotë''Luan i shtrirë'',
Si gurë xehori, vargu vetëtimë
Historitë e shqipes, në djep aty rrinë.

Emrin e ka nënë

Hapësirës së qiellit pashë yjet
Pastaj, si gonxhe zambaku të bardhë,
Udhës së qumështit, diku ata ndaluan.
Atje gjetën zemrën e nënës
Me dashuri derdha si petalet
Kujtimet e lotët si ujëvarë.
Ndriçon loti im si ylli polar
Nënën kërkon çdo ditë në thërmija dheu,
Kaluan vitet e loti u bë ar
Me dashuri puthi yllin në qiell
Se ai si nëna i ngjau.
Ah, kjo botë pa nënën se si qenka
E veshur me fustan akull të antraktidës,
Të gjitha fjalët heshtin si statuja
Dhe shkrihen si meteorët në hapësirë
Nga fjala e zjarrtë që emrin e ka nënë!

Zenun Gjocaj, o burrë stralli

(Mësuesit atdhetarit e veprimtarit të shquar)

Fryn era, e hap fletët e jetës
Kënga e Zanave te kroi i fshatit,
Puthi syrin e të bulurës hënë
Ashtu kishte fjalën e zemrës
Që piu qumësht në gji të nënës.
Zenun Gjocaj, sokol mali
Mendimtar që kurrë s'u ndali,
Që nga bjeshkët e Junikut
Në Padesh e Reç të Zogut;
Atje te Livadhi i Madh
Fjalën e kulluar rrodhi.
Atë prill të '43-shit
Çeli lulja e këndoj bilbili,
Te kroi , vrapin zana ndaloj
Kishte lindur Zenun Gjocaj
Edhe dielli fortë e përqafoj.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Lum nëna kë djalë përkundi
Me ninullën e këngës nënë,
Përmbi krahët e saj u rrit pëllumbi
Atje kish' lindur e Din Mehmeti
Poet që se trembi dot as tërmet.
Tek natyra e fshatit Gjocaj
Melodinë e fjalës mori,
Edhe dritën e
shkronjës shqipe
Në Junik e shkrove të parë
Gjimnazist atje në Pejë
Për kombin mbete gur me vlerë.

Por si dielli që lind mbi kreshta
Mësimdhënës shkon në Jasiq,
Fëshfërin fjalët nëpër lastarë
Ç'ke o lot që rrjedh si ar!?
Fjalën shqipe me gjak e shkruan
Zenun Gjocaj në Deçan.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Kur kujtojmë vëllezërit Frashëri
Ndizet zjarri i dashurisë,
Për atdheun e lirinë
Mësues shkon në Vican.
Ramizija në Novolan
Bëhet lule, e plagët shëron.

Malli ynë, këngën e ndezi
Agim vëllai gonxhe çelur,
Ish ushtar i UÇK-së,
Në altarin e lirisë
Nënë moj i gjallë mbeti.

Si vesa mbi trëndafil
Zenun Gjocaj,- dritë si ylli,
Në çdo zemër të fëmijërisë
Edhe vdekjen e sfidon
Emri yt fal dashuri.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Edhe fshati Gjocaj
Mbushur plot me gjelbërim,
Rrugicat seç po vajtojnë
Bashkë me to e shpirti im.

Lotët ngrinë nëpër faqe
Edhe djepi u trondit,
Bankat zunë ato po
qajnë ,
Zemra e Zenun Gjocajt
seç u fik dalëngadalë.

Dhe me këngë e ligjërime
Zenun Gjocaj do e kujtojmë,
Kush me fjalë të shkruar me penë
Këtij burri si gur stralli
Përmbi bankë i ngrejmë folenë.

Durrës, 28 qërshor 2014

Nostalgjia e pikave të shiut

Pikat e shiut trokasin nëpër dritare
Ç'është kështu?Jashtë ka rënë heshtje vrastare;
Dëgjohen tik-tak në xhama,shi,shi,shi,.....
Në qiellin gri duket sikur s'do ketë pafundësi....!

Dielli fshehur qëndron në qiellin mes reve
Si shtëllunga pambuku kapriço të bardha ,të zeza,
Pikat e shiut rrëshqasin si sumbulla loti në dritare
Pastaj, në ato pika derdhen vetëm brenga.

Befas pas xhamit shfaqet një komedi
Trokitjet në xham më si dëgjon,
Natyrë e qetë, e gjelbra shpirtin ta ngroh
Nostalgjinë e pikave të shiut pastaj përjeton.

Durrës, 17 Maj 2011

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Loti i argjend

Loti i argjend pikoi nga lastari

Dhe lulja në saksi këputi petalin,

Hëna mes yjesh vështrimin e ndali

Vajza sykaltër veten pse shmangu?!

Ju vite me shtrëngata ku shkuat?

U tretët si kripë e u bëtë vesë,

Qetësisht u larguat si gjethi i thatë

Tek trungu i pemës aty ndaluat.

Ndaloni një çast trokitni prapë tek unë

Pse jo,ta di mos ndaj zotit kam bërë mëkat,

Ah, jo kjo jetë qenka vërtet si ëndërr

Pastaj,sykaltra puthi dritën e hënës.

Ç'kërkon tjetër moj mike nga unë

Tingujt e petaleve përsëri u zgjuan,

Dhe loti i argjendtë pikoi në rrënjë

Prapë lastari i jetës po rritej ngadalë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Fletëza urimi të bardha bore

Vendlindja ime çdo ditë më thërret
Se, nga gurët e dheu yt u bëra poet,
Te krojet e fshatit ndalove një çastë
E ngjeva penën me ujë të kristaltë,
Pastaj, me mall shkrova vargun e artë.

Dallgëndezur në zemrat tona malli
Kujtimet u zgjuan atje mbi Selishtë,
Loti i vesës me dritën e diellit
Lotuan mbi emrat e skalitur
në gurët e mermertë.
Ashtu në heshtje,
Në Qafën e Obruzit
I puthin me radhë çdo ditë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Ju lule të bardha akace
Pikëllimit të zemrës i falni petale,
Atje në Tomorr, ku dielli perëndon
S’ bashku me ujërat e vendlindjes Leskovë,
Ndalojnë te deti Adriatik, një çast
Takojnë poetin, fjalën i lënë uratë.

Nuk e fsheh dot lotin nën qerpikët
Le të rrjedhë në faqe e gushë;
E dëgjoj oshtimën e ujërave të Ravenit,
Dhe pjalmin e luleve të mollës e qershisë
nga larg ato i thithë.
Me kallëzat e grurit, ia thonë këngës,
Nën hijen e gorricave atje në fushë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Mbrëmjeve hëna fshatit vesh
vellon e nusërisë,
Kujtimet e mija aty lundrojnë
Me heshtjen – dritën e artë.
Kuvendoj me gurët, baltën, krojet…
Si e lash vendlindjen
Ku piva qumësht nga sisa e nënës!?
Fjalët obelisk shkruar mbi çdo gur,
Emiljani shkrep aparatin e qëndis
foto atje në fshat.
Pastaj, dashuria zgjohet te çdo bashkëfshatar
Miliona fletëza urimi të bardha bore,
Ju uron poeti, mbarësi e fat!

Durrës, 23 dhjetor 2013.

Lotdhimbje nëntori

Epitaf (Sokol Olldashit)

E kobshmja natë erdhi tinëzare

Vrapoi diku e atje u ndal,

Mbi gurin e bardhë,shkreptiu vetëtima

Një zog mali me emrin Sokol

Te retë e bardha aty e ndali.

Pas kësaj lotin e dhimbjes ,

në plisin e dheut e fali!

Nëntor, e Enjte 2013

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Fshatit tim të lindjes

Gurët e vendlindjes në trup më janë mbjellë
Nga thërmiat e tyre trupi im ndërtuar,
Në vena shpërndarë gjithë damarë
Gjaku brenda tyre derdhet si ujëvarë.

Vrapon mallëngjimi për tek ty vendlindje
Si zogjtë shtegtarë nëpër kontinente,
Pranë krojeve të fshatit ëndrra ime fle
Kur vijmë aty,si bisku i barit të dy përqafohemi ne !

Tek ty më treten vitet si gurë meteori
Aroma e luleve buqetë me ujë të kristaltë lajthie,
Mbi baltën tënde gëzimet thithën pika loti
Unë largohem, por rrënjët lash aty Leskova ime.

Mbi kreshtën e malit dielli derdh rreze të artë
Vesën e mëngjesit thanë fushës së Myzeqes e Elbasan,
Të heshtura shtëpitë vështrojnë Tomorrin plakë
Guri i vendlindjes nën jastëk fshehur mallin mban.

Durrës, 26 Maj 2011

Peneli i piktorit

(Këtë poezi ia kushtoj piktorit Nuri Jaupit)

Ngjyrat e ylberit derdhur mbi telajo
Poezinë e shpirtit stolisur në gonxhe,
Dhe shkëmbinjtë e malit aty janë stamposur
Lum' e valë e detit zënë fortë për dore!....

Ja ku është Valbona, Lura plotë dritë
Vajza kosovare me flamur mbi gjitë,
Ura e Kasabashit tregon historitë
Në Tomorr pikturat marrin kaltërsitë.

Vrapin ndal piktori atje në valëdeti
Ngjyrat në peizazhe agimet i ndezi,
Valltarët mbi gurë sumbulla hedhur vesës
Si ortek bore -vallja jonë e bjeshkës.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Ura e Goricës me harqe dishepuj
Në penel buzëqeshja - portreti i etur,
Mbi lumin Osum numëron shekuj
Ngjyrat e peisazhit si kripa janë tretur.

Ëndrra fluturon me ngjyrë akuareli
Tek burimi i fshatit shuan etjen e mallit,
Nektari i zemrës në piktura ngeli
Dora e Nuriut si hojet e mjaltit.

Durrës, 22 qërshor 2011.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Asllan Ademit- Prishtinë

(Urimi për 78-vjetorit të Asllan Ademit,plakut të urtë Prishtinas ,
dhe katër vjetorit të Pavarësisë së Kosovës martire.)

Vrapojnë vitet tek viti 78-të
Me qindra urime, kaltërsi deti,
Petalet e viteve do rrinë
Aty për jetë
Pranverë zemre, Asllani do ketë.

Ai burrë me thinja i heshtur vështron
Vitet në kraharor të fshehura i rrinë,
Urimi i fjalëve në përvjetor pavarësie
Kosovës e Asllanit i shkojnë në Prishtinë.

Buqeta e luleve Mimoza
Në shpirt do çelin përherë,
Le të jetë dhe vargu im
I përjetshëm për vitin 78-të.

Mars, 2012

Shënim:

Asllan Ademi është i ati i poetes Drita(Adem) Beqiri, e cila jeton në Zvicër familjarisht.

Ulliri që puthë hënën…

Ulliri shekullor me degë varur
Sa shekuj dritëjete supit mban?
Rrënjët kodrës ai ka ngulur
Rrathët mbi trung si piktura ngjan.

Mbi gur u ula nën ulli
Të ashprën lëvore preka pastaj,
Këputet një gjethe,më ra në gji
Ajo më numëron shekujt, sa çudi!

Kokrrat në degë si dy buzë të varura
Muzgjeve të mbrëmjes zogjtë rrinë aty,
Mes gjumit dhe këngës plotë melodi
Pa tjetër,nën hijen e ullirit ka dhe dashuri.

Rrezet e diellit u tretën mes dallgëve
Dhe muzgu i mbrëmjes erdhi përsëri,
Ulliri puthte dritën e hënës
Aty në shekuj, kodrës për bri...!

Sytë e kaltërsive

Sytë e asaj vajze janë të kaltër
Dhe brenda tyre lexon vetëm jetë,
T'i kisha dhe unë, jo për hatër
Sa çudi do të ishte me të vërtet!

Vrapova rreth botës si Magelan
Askund s'gjeta të tillë sy të kaltër,
Aty mes malesh si jargavan
Dy vajza e djali rrinë sy hapur.

Njëra vajzë e ka emrin Lurë
Dhe tjetra emrin Prespë e ka,
Ujëra rrjedhin nën akull e borë
Tek sy kaltra vallëzon veç zambak.

Dhe djali mes pulëbardhave-Ohri
Shtegton nga Korabi në Mal të Thatë,
Takon motrën Lurë e Prespë me dashuri
Kështu janë vendet e mija:vërtet si mjaltë.

Loti i nënës

Ndoshta, o nënë keq jam sjellë me ty
Dhe me pa të drejtë ti kam lagur
Ata sy,
Loti yt,o nënë,
Pa gënjeshtra e zmadhime
Bije si shigjetë
Këtu në zemrën time.
Prandaj o nënë
Mos mendo se s'të dua,
Se kjo botë pa ty,
S'më duhet mua.
Vetëm një perëndi
Qenka në këtë botë,
Nënë i thënkan perëndisë
Që ajo të mëkon.
Nuk ka bir në botë,
Që nënën mos ta duaj
Prandaj unë lehtësohem për ty
Kur zë e nis të shkruaj.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Mallkoj unë veten
Si s'të kuptova dot,
Që fjala jote
Nga guri të vriste më fort'.

Por mua o nënë ti pse s'më mallkon
E arrakatin tënd ti fort e do,
Ah, harrova që nënë nuk ka në botë
Të birit harram i mallkuar ti thotë.
"Respektin kërkon nëna
prej teje o bir,
bëja këtë nënës
sa është në këtë botë,
se po u kujtove vonë
çdo gjë është e kotë."

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Shqiponjat Arbërore

*(Ia kushtoj 28 nëntorit të 1912-ës, ngritjes të flamurit tonë kombëtar në qytetin e Vlo**rës)***

Nga thellësia e shpirtit erdhi loti i detit
Si ujë Valbone rrodhi për mbi faqe,
Pranë gjirit të nënës kokën fortë mbështeta
Tek shqipja me dy krena bijtë e saj gjejnë paqe.

Afrohem e lulëkuqen këputa atje tek zalli
Dhe shqipes sime ia vendosa në ballë,
Ëndrrat u zgjuan ku piva qumështin e nënës
E gurët e dhimbjes u tretën aty dalëngadalë.

Eca,eca i përgjumur në pesë kontinente
Si anije nëpër dete mendimet shtegtuan si magelan,
Shekujt e pabesë gjakun derdhën në tokën Arbërore
Ndërsa lulëkuqja në sfond shqiponjën në gji mban.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Gjethet e përflakura të nëntorit vjeshtak
U shkundën nga shekujt rreth trungut të vet,
Shumëngjyrat bashkoi,- nga ato lindën vetëm dy
E kuqja, e zeza shkruan fjalën **PAVARSI!**

Shqiponjat Arbërore zbritën në Vlorë
Dielli i nëntorit ngrohu ngjyrat **Kuq e Zi,**
Në valët e flamurit akujt e shekujve u shkrinë
Dhe puthjet e Isa Boletinit vulosën **Pavdekësi!**

Durrës,nëntor 2011

Kitara mbi barakë

Atje, flladi i erës së detit lëkundte
Gjethet e pishave hijerënda,
Nga drurët me ngjyrë të hirtë
Në kënetën me bar zhukë, ndërtuar baraka.

Përtej atyre ishte vezullimi i detit
Në gjol bretkosat këndonin këngën e tyre,
Ndërsa atje mbi barakën e vjetër
Kitara në heshtje shkruante pentagramin e saj.

Simfonia e tingujve,dëgjohen brenda strehës
Kur pikat e shiut vjeshtak i lagnin trupin,
Erërat e çmendura fryjnë e ndalin aty
Pastaj,gjethet e zverdhura kitarën e puthnin.

Atje, mbi barakën e vjetër një kitarë
Qëndron shtrirë e vështron qiellin,
Ashtu në heshtje, me sy të përdalë
Yjet numëron, s’është më e gjallë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Ndjellëzeza marrëzi u shfaq tek ajo barakë
Dikush gjuajti me çifte mbi kitarë,
Saçmat u derdhën, në trup hapën plagë
Nga kjo ditë atë e gjen vetëm duke qarë.

Pentagrami i heshtur së kitarës
Në barakën e vjetër,mbi çati qëndron,
Vesa e kripur mëngjeseve plagët i mjekon
Ndërsa mbi tela natën Korbi shpend,
Këngën e dhimbjes asaj i këndon.

Durrës,09.06.2012

O moj Vlusha heroike

Për ty o Qemal Skrapari
Këngën me iso këndoj,
Si Tomorri lart qëndron
Zemra mjaltë të kullon.

Anë e mbanë Shqipërisë
Mbolle gjurmë mirësie,
Që nga lufta partizane
Meteor i kësaj ane.

O moj Vlusha heroike
Bijtë e tu ku i ke?
Në luftën e dytë botërore
Gjakun derdhën për atdhe.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Në ballë të qëndron Nuriu
Patrioti që s'u ndal,
Sot Qemali mal mbi mal
Historinë në libër shkruan.

Nga zemra të urojmë
Në shekullin e Pavarsisë,
Si malet ngarkuar me borë
Urimet tek ty qëndrojnë.

Gusht, 2012

I shtrenjti Atdhe

(Me rstin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarsisë

E dua Atdheun tim
Aty ku avujt,
Nga toka dalin me nxitim.
Unë dehem pa dashur
Dhe tik-taket e zemrës,
Mbjellin fjalën urim
Në këtë 100 vjetor
Vlorë je dritë e plotë nur.
I shtrenjti Atdhe të dua
Me rrënjë lisi-pavdekësi,
Dhe trungu i trupit në plisa
Pastaj me dashuri
I putha në pafundësi.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Shqiponja krahët i përplasi
Atje mbi gurë stralli,
Shkëndija zjarri u ndezën
Në sfondin Kuq e Zi

U shkrua 28 Nëntori.
Në shekuj u derdhën
Lumenj gjaku,
E qindra fjalë vrapuan tek ty
Pastaj Vlora këndoi këngën
Mot e jetë në Liri!

Durrës,17.11.2012

Vajza me emrin Erta

(Ia kushtoj vajzës së shokut tim Partizan Myftari-Itali)

E çuditshme qenka kjo jetë!?
Kur linda unë,
Ishte muaji gusht.
...E datës pesëmbëdhjetë!

Dikush në gjumin e ëndrrës
Erdhi e u ndal te unë,
Pastaj, më foli me të vërtetë
duke më thënë:
Ditëlindjen e ke me një Poet!

Nga qielli u këput një yll
Pastaj, dalëngadalë
ai erdhi,
e mbi vetullën e vajzës
Xixëllonjë aty mbeti.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Atë ditë të çelën
Lulet qiellore në zemër,
Dhe hëna mes yjesh vezullimesh
nuk vonoi
Por shkroi me germa të arta
ERTA!

Pastaj, me tingullin
e vargut
Poeti të përshëndeti:
Lule e bukur,Tunnjatjeta!

Durrës,9.12.2012

Puthje në mermer të bardhë

(Baladë për babanë tim Remziun)

Vitet janë strukur diku në heshtje
Pas tyre, loti i kripur ende pikon!...
Nëpër muzgun e natës dëgjon
cicërima zogjsh që qajnë.
Vetëm kur agu i ditës zbardh,
Atëherë ata këndojnë.
Vonë mbrëmjeve kënga e tyre,
ndalon në vajtim!
Aty në kodrën e qytetit me emrin ‘’Vilë’’
Ku dallgët e detit bëjnë ‘’gjumin’’.
Zogjtë kuvendojnë me njerëzit
e qytetit të mermertë.
Çdo cicërimë e tingull
Aty në degët e pemëve të Selvive,
puthin germat e shkruara të arta
Emrat mbi pentagramet e pllakave
të gurëve të ftohtë.
Ishte katërmbëdhjetë shkurti 2001,
Fjalën’’Lamtumirë’’babai shkroi

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Me lotin e kripur nëpër faqe.
Në vend të fjalës :Amanet!
thau dy liqenet blu
për t'u bërë obelisk.
Sa herë që vete aty
Një lule e fije bari më përshëndet;
Nuk vonoj edhe unë
Afrohem pranë fotos së babait
E puth, pastaj ledhatoj emrin e shkruar
në mermer të bardhë.
Në këtë çast vetiu
Loti i kripur nëpër faqe rrëshqet,
Nga thellësia e nëntokës
Vjen një zë i ëmbël e bisedon me mua.
Pastaj, lulja e bari që rrinë aty pranë
Më qortuan e më thanë:
''Mos loto biri im! Loti e puthjet
në mermer të bardhë,
treten e takojnë babanë!''.
Kurse Epitafet natën
puthen nga drita e argjendtë e hënës.

Durrës, 14 Shkurt 2013

Dialog te guri i vetmisë

Të pashë që hyre nga porta
Si një tinëzare erdhe te unë,
Nuk trokite, por me hap të ngadaltë
U afrove e m'u ule në gjunjë.
…Dhe unë mora frymë thellë
Të vështrova ashtu në heshtje,
Në parmakun e portës u ule
Sikur të dy të mos ishim aty ne.
Një dritë rrufeje doli nga zemra
Vetminë - errësirë e ndan në dy pjesë;
Dhe vargu i poetit bëhet plug
brazdat në libër i mbush me farë
pastaj…filizi fjalë takon retë.
Por doja që ëndrra e vetmisë
Të udhëtonte shtigjeve të jetës;
Dialog me gurin të bënte
aty nën thellësinë e nëntokës,
Vetmia me ëndrrën,
me gurin të bashkëbisedonte.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Kjo ëndërr e thyer si xham pasqyre
hijezezë i ngjan shpendit Sorrë,
Vetmia njerëzore udhëve shkundet
Si gjethet e verdha të vjeshtës
Sa një ditë harron edhe puthjet.
…Dhe ëndrra
Takon engjëllin e bardhë,
atëherë vetmia bën dialog
me heshtjen te guri i vdekjes.

Durrës, 24 Maj 2013

Kohëthyera ëndërr

I thashë ëndrrës
të flinte në supet e mija,
Ajo s'më dëgjoi
dhe nëpër hapësirën kozmike,
vrapoi diku gjumin të bënte.
Unë s'jam i dehur,
helmin e trishtimit
Do e zbraz gjer në thellësi të detit.
Guaskat i mblodha në grushtin tim.
Pse kaq shumë paskan vdekur!?
Valsi i valëve të detit
Tunnjatjeta një ditë më tha;
Më ledhatuan aty te bregu
…me vete kishin marrë
Edhe kohëthyerën ëndërr..!

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Yjet në qiell qëndronin
si xixëllonja të varura në pemë,
ndërsa në trupin tim
dukshëm janë vizatuar,
si vija karbon tymi
që avioni lëshon në fluturim.
Eh, kështu me ëndrrën
të dritës erdhëm në këtë jetë,
S'ka gjë, se një ditë
Meteorët e viteve do treten.
Pastaj…do dëgjohen
vetëm tingujt
e kohëthyerës – ëndërr!
Paskësh pasur të drejtë
kohëthyera – ëndërr,
që s'fjeti në supet e mija.
Ndoshta, ajo na pretë
Gjumin ta bëjmë s'bashku
Në folenë e supit të sajë.

Durrës , 17 Korrik 2013

Nesër baladë do mbetesh

Këmishëzezën e gjumit
nata kishte veshur,
…dhe brenda saj vezullonin yjet.
Në parmakun e dritares
qe ulur një pëllumb ,
priste valsin e këngës me pa durim
të pushonte pak çaste,
në qerpikun e syfjeturës ëndërr.
S'desha që gjumin t'ia prishja
Thash që mos t'i trembja ëndrrën,
Me gjethet e verdha vjeshtake
Le të loznin në pyllin e lisave.
…Pastaj, s'bashku me ëndrrat
U shkundën me gjethet e pemëve,
Valsi i viteve të këngës
Dhe u takuan,
te frytit i shegës së ëmbël.
Mos rri e trishtuar sykaltra ime
Zgjoi ëndrrat në kupën qiellore,

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Pastaj, një e nga një yjet
Merri në gishtat e dorës.
…Pas kësaj ,le të ndizet
zjarri në gjoksin eshtëror.
Eh, mikja ime ëndërr dritëjete
Nesër baladë do të mbetesh,
atje në vesën e mëngjeseve
me yjet qiellore,
Këmishëzezën e natës do grisësh
Duke shuar etjen e pavdekësisë.

Vallëzo me yjet

Zgjata krahët drejt teje
Si dy shtiza kalorësi mbi kalë,
që gjuan gjahun në pyll.
Pastaj…të heshtura diku
në errësirën e natës
vallëzojnë yjet me fjalët.
Të egra janë ditët e jetës
Në kupën qiellore të tyre,
shikon re të zeza.
Veç zoti e di paskëtej
Ngjyrë e fjalë me shije portokalli,
dhe fëshfërima e gjethes vjeshtake
rënkimin e dhimbjes dëgjon
hingëllimën e një kali!

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Vrapo pas kohës thinjoshe – jetë
Te tingulli fjalë ndalo,
Pastaj, në shportën e saj
Fjalët e kockat grumbullo.
Mos kalëro si një i marrë
Shtigjeve të egra të jetës,
Por, zgjidh lulen e bardhë të mollës
dhe kaltërsinë e qiellit.
E nesërmja të pretë
Të vallëzosh me yjet.

Guri i syrit të vesës

Koha ecën e shkel mbi gjurmën e reve
Hapësirës qiellore fluturon e ndal diku,
Pastaj zbret në tokë dalëngadalë
Në eshtrat e mija ndez zjarrin e fosfortë.

Te parmaku i portës s'viteve jetësore
Ulem e bashkëbisedoj shtruar me to,
Aty në vallëzimin e shpirtit tim
Takon erën e shekujve e fjalën zgjon.
Tingulli i jetës ecën me bardhësinë e reve
Dhe drita e hënës argjend'plotë
Mirëmëngjes çdo ditë më thotë.

Mos përgjo në heshtje
Si një gur i ftohtë,
O miku im!

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Mbi qepalla të syve derdhi
Lumenjtë e sydritës jetë,
Bashkohu me retë e bardha qiellore
E fli netëve me to.
Eh, koha ime- dritë
Largo kohëzezën errësirë,
Në qoftë se s'mundesh dot
Puthi gjethet e argjendta të vjeshtës.

Pastaj, le të dëgjohet
Tingulli i jetës sime,
Atje te guri i syrit të vesës.

Durrës, 10 shtator 2013

Pentagrami i stinëve

U përgjum trupi i stinës së dimrit
Ashtu si një lëvore peme e plakur,
Kjo stinë ndalon edhe buzëqeshjen e blinit
Patjetër, e nesërmja do zgjohet nga sythi i fjetur.

Mozaikët e akujve atje në antraktidë
Ylberet e ngjyrave të akullta dritë vezullojnë,
Mbi akull vallen hedhin pinguinët krahëbardhë
Kënaqësitë derdhin ata kur shkundin krahët.

Te stina e dimrit gri, fle dhe pranvera
Nën çarçafin e borës lulet dremisin,
Mozaikët e akujve thyen si lisa
Nga përgjumja lulet zgjohen e harlisin.
Kënga e zogjve të thotë tunnjatjeta
Dhe erës vjeshtë-dimër i kap në kthetra,
Mbi shkëmb çel dhe lulja e pranverës
Në gjokse fëmijësh shkruar pentagrami i verës.

Durrës, 11.01.2014

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Më e shtrenjta fjalë

Pse ky qiell i errët
Pa yje e dritë,
Misteri i kozmos
Shpirtit vallen zënë.
Fustanella hapet
Hedhur përmbi hënë
Më e shtrenjta fjalë
E pavdekshmja Nënë.

Ndaloni një çast

Në terrin e natës
Natën pa hënë,
Kërkoja të gjeja diçka
Kërkoja të gjeja buzët e saj
Dhe puthjen t'i merrja pastaj.

Kërkoja të gjeja dy sy të zinj
Por kërkova dhe gjeta
Një trup njeriu;
Me një tufë lule
Vendosur aty përbri.

Pra, kërkova dhe gjeta
Dy sy të mekur,
Dhe një njeri
Gjysmë të tretur!

Hej , ju
Kortezh i përmotshëm varrimi!
Ndaloni një çast
Ku jeni aty,
Vajzën në duart e mija e lini
Një çast…,
Sa t'i shoh të bukurin sy.
Hej , ju

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Kortezh i përmotshëm varrimi!
Ndaloni një çast
Ku jeni aty,
Vajzës t'i tregoj
Për kë lotojnë këta sy.
Lotët që u derdhën mbi arkivol
Puthjen e fundit atje lanë
Në përjetësi, fshehur nën kraharor.

Durrës, dhjetor 2014

Vargu i poetit t'u bë kurorë

(Heroinës Antigona Fazliu - Kosovë)

Antigonë motër, nur si drita e hënës
Si nuse e bukur shtegtoj drejt lirisë,
Dhe kokën mbështeti në gjirin e nënës
Nëpër plisa dheu, atje në Gradicë
Bukur fjalën shqipe aty e qëndisë.

Lulet e bardha të marsit, t'u bënë jastëk
Le të ishte i acartë mot i vitit '81,
Antigona Fazliu, - puth qiellin e Kosovës
Dhe jehonën e këngës dëgjoi e shtrenjta Liri!

Dëgjoj meloditë e gjetheve të lisave nëpër Kosovë
Plagët e shekujve u zbrazën si rrufe në zemrën tënde;
Si pesha e shkëmbinjve të sertë atje në Drenas
Kobzezës së shekujve me gjakun tënd u vure fre.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Ç'emër të bukur plot dritë t'a thirri ajo nënë
Si xixa gur stralli emrin Antigona të tha babai Agush,
Me dashuri mjekove plagët e luftëtarëve të lirisë
Se në zemrën tënde qe ndezur zjarri i lirsë, prush.

Ah, motër Antigonë, e veshur me këmishë
Të kuqe të ngjyrosur dhe nga gjaku yt ,
Atëherë ishe shtatëmbëdhjetë vjet, shqiponjë
Kur në rreshtat e brigadës 114-të, të UÇK-së
Mbete yll i pashuar për atdheun, gjithmonë.

Ajo fluturon e lirë me krahët e shqiponjës
Në qiellin e kaltër të Kosovës, - dielli ngroh i lirë;
Vendlindjen Verboc të Drenasit, përshëndeta
Heroinën Antigona Fazliun me grushtin lartë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Antigona motër, lule prilli mbete
Kur shkojmë në Prishtinë na thotë: Tunnjatjeta!
Me petale gjaku, - emrin ta skalitëm
Zërin tënd të ëmbël, ta dëgjon rrugica.

Mëngjeseve çelur trëndafila në Kosovë
Çdo ditë ujiten me gjakun e dëshmorëve,
Në gjokse luftëtarësh, shkruar fjala Liri
Antigona e lirë në tokën Dardane.

Emrin Antigona, - shkruar në mermer të bardhë
Nga ai çast vargu i poetit t'u bë kurorë,
Toka Dardane dëshmorët mban në gji
S'e nga gjaku i tyre u shkrua emri Liri!

Durrës, 16 prill 2015

Ditëlindja e vajzës

Kam një vajzë
Me emrin Mirela,
Në një ditë korriku
Ajo më tha: ‘’Erdha!’’.
Ishte natë me yje
E dritë i jepte hëna
Përkëdheljen e parë
Me duar ja dha nëna.
‘’Babë’’ e ‘’Nënë thotë Mirela
Të gjithë e uruan me radhë
Ditëlindjen gëzofsh njëqind pranvera.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Shtegtimi i poetëve

(Ia kushtoj poetit Bashkim Gjoza, që u nda nga jeta para disa kohësh)

- …u thashë gishtave të dorës,

Largohuni nga plaga e dhimbjes!

-… heshtën...!

-… si ditët e acarta të dimrave…!

- …fjongon e zezë, ata aty lanë.

- … S'do këndojmë si një ditë më parë,

Në buzë vargu i poetit kishte ngrirë.

-…lapsi heshte tek një fletë e bardhë

Me njerëzit bashkë lotonin,

edhe zogjtë nëpër degët e plepit të tharë.

-…nata e përgjumur kishte ikur…!

-…të ngrohte dheun e varrin e poetit.

-…si kristale të vesës mëngjesore

-…trishtimi në plagën e dhimbjes tretur.

-…s'është e vërtet ikja e poetëve..!

Ata diellërojnë në çdo plagdhimbje.

-… në shtegtim fjongo thurur poezia

-…bëjnë dritë në shpirtin tonë,

Vallzojnë në qiell s'bashku me yjet.

Durrës, 22 Janar 2015

Lot me pika gjaku

Luanesha Antigonë
Meteor qëndron mbi kodër,
Lavdi – loton me pika gjaku
na i shkrove në çdo zemër.
Atë ditë puthe flamurin
Fluturove për mbi re,
Sot je diell për Atdhe.

Maj, 2015

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Rrënja e dashurisë

Tinëzare më vjen nëpër ëndërr
Dhe mbrëmjeve më fshihesh diku,
Në pasqyrën e saj u shfaqëm të dy
Ti nuse veshur me lule të bardha
Kurse unë trëndafilin e kuq ta lash mbi gji.

Buzëqeshjet e tua nën hënën e qiellit
Më thoshin fshehurazi fjalën të dua,
Iu luta dritës së hënës atje mes yjesh
Puthjet ëmbëlsisht u derdhën tek ty, tek mua.

Ti veshur nuse e unë dhëndër
Mbi fustanin e bardhë zambaku çeli,
Në çdo petal fjala dashuri shkruar
Pastaj, lot gëzimi u derdhën mbi mua.

Të dy kishim pritur gjatë nën dritën e hënës
Egërsisë me shpirt i thamë : ’’S’të dua!’’,
Zemrat që duhen, s’pyesin për gurë e furtunë
Atje ngul rrënjën përjetësisht - dashuria.

Kujtim i vjetër

Në gjoksin eshtëror fshihet diçka
Aty gjen germa të arta fjalësh,
Pas tyre pikojnë si vesë plotë kujtime
Te lëmi i grunjtë me presje e pikash
Nga egjri vitet ndajnë kujtime gëzimesh.

Sënduku i vjetër kishte dhe një sirtar
Pas kaq vitesh e hapa, aty gjeta një letër,
E verdhë, e zbehtë letra, e vargu rënkonte
Hapa letrën, ajo më rizgjoi kujtimin e vjetër
Në letër te vargu, kujtimet e freskëta kishin mbetur.

Maj, 2013

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Plisi bardhë – këngë lirie

(Kushtuar dëshmorëve të kombit tonë me rastin e 26 vjetorit, Fahri Fazliu e Afrim Zhitisë)

Ah moj zemër si durove

Kodër e Diellit ndezur flakë,

Supit derdhur petale nëntori

Rrënjë e lisit larë në gjak.

Vijnë nëntorët e shkojnë përherë

Këpusin gonxhe trëndafili,

Fahri Fazli e Afrim Zhitisë

Këngë trimi u këndon bilbili.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Ish nëntori i ’89 –ës

Plisi bardhë ra në zi,

Qante toka arbërore

Dy djem ranë për liri.

Dhe shqiponja në flamur

Lotin derdhi pikëllim,

Kodra e Diellit – dritë e nur

Me një zë ata thanë:

Gjak të falim ty atdhe.

Nëpër shekuj u derdh gjak

Vij unë sot nga Shqipëria,

Me kurorë – lule nëntori

Solla vargun nga Tomorri.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Për dy djemtë që ranë si luanë

Kishin bërë veç një betim:

Edhe jetën s'do kursejmë

Të jesh i lirë atdheu im.

Dy nëntori i '89 –ës

Fshihën lotin e robërisë,

Fluturoi e lirë shqiponja

Për mbi bjeshkët e Drenicës.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Sot krenohet mali Sharrit

Plis i bardhë – këngë lirie,

Ja ku është Adem Jashari

Gjallë simbol i vegjëlisë.

Unë poet nga Shqipëria

Solla vagun në Kastriot,

Kodër- Diellit, dritë e nur

Dy nëntor shkruar në flamur.

Durrës, 28 tetor 2015

Çamëri, gonxhe e dhimbjes

Çamëri, je yll që rri pranë hënës

Jo, s'e harrojmë qumshtin e nënës,

Mallin tonë se tret as deti

Në gjoksin tënd të coptuar

Të është zhuritur edhe gjethi.

Ashtu ,si limon dhimbja të ka mbetur

Zhur i djegur gjer në kockë,

Lotët që derdhen tretin edhe gurin

Do vijë dita që të jemi pranë teje

Se ti Çamëri je zonjë

Ndaj rrezaton si ylber mbi dete.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Kur dielli lind

E puth tokën Çame,

Trëndafilat çelin ganxhe çdo mëngjes.

Nga varret e gjyshërve

Tek unë vjen një zë,

Ah, moj nënë sikur të isha atje

Gurët e varreve t'i puthja

E t'i lagia pastaj

Me gonxhet e dhimbjes të larë me vesë.

E megjithatë,

Gonxhen e dhimbjes

Varur e lash te një ulli

Aty tek ty Çamëri.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Dikur dëgjohej kënga e jetës

Pranë sofrës u ul një zog

I vetmuar kishte mbetur tek ai fshat;

Përlpasi krahët derisa pendët u shkulën

Me dëshpërim e lot në sy

Vështroi Tomorrin plak.

Ku shkuan vallë pendët në fluturim?!

Hapsirës së qiellit së mërgimtarit kërkonin

Një emër djali te një lule shkëmbi

Atje, te Bregu i Kishës një çast ai ndali.

Në kryqin e kohës ora seç ndali

E puthi ballin e nënokes Asime,

Trishtimet e zverdhura si gjethet

E vjeshtës nga degët ranë

Nga pisha te varrezat

Qindra yje ndriçuanë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Shtëpitë e fshatit Zhepë i shohë tani

Dhe duartë zgjas çative të ngrysura,

Dikur dëgjohej kënga e jetës

Ndërsa sot dyer të kyçura

E përgjumur edhe heshtja.

Një flutur e verdhë zbret nga Koshnica

Qëndron e vajton mbi një çati,

Sa mall kam për ju o njerëz!

Etjen e mallin

Ma shuan vetëm ujët e rezervuarit.

Si nëpër baladë mendimet i hoqa zvarrë,

Dhe ëndrrat rrugicave të fshatit fluturuan,

Mbrëmjet e lodhura këtu në mërgim

S'bashku me ëndrrat u kthyenë në vendlindje

E puthën me radhë gurët e të parëve të mij.

Zogjtë i thanë trishtimit ,- largohu!

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Dhe mbrëmjet e dimrit u bënë pranverë.

Gurët e rrugicave atë çast

Mbetën pa fjalë,

Lotit e trishtimit i thanë:

‘’Vendlindja ime, ja ku jam

Në gjirin tënd, të erdha pranë!’’.

Durrës, e diel 21 Shkurt 2016

Te lulet e blirit

M'u shfaqën ëndrrat, ashtu pa pritur

Te liqeni i kaltër i shpirtit tim,

Zambakët e bardhë vallzonin atje

Dhe vesa nëpër fije bari

Putheshin nën rrezet e arta të diellit.

Më prit e dashur, bëj pak durim

Nëpër rrugët e atdheut do ecim të dy;

Te lulet e blirit u rritën dashuritë

Dhe yjet buzëqeshnin e përqafonin fëmijtë.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Si flutur erdhi dhe ëndrra dashuri

Zambakët e bardhë këngës ia thanë,

Liqeni i shpirtit ëndrrat mbante në gji

Rrugëve të atdheut do të ecim gjithmonë

Padyshim , unë edhe ti.

Dhe ëndrrat u bënë tinguj violine

Zambakët e bardhë në liqen krahapur rrinin;

Valët vallzonin me të dashurën dashuri

Ndërsa kënga e zogjve dëgjohej tutje në hone.

Maj, 2016

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Autobiografi

Ka lindur në fshatin Leskovë, Tomorricë-Skrapar në vitin 1959. Arsimin fillor e të mesëm e kryen në vendlindje, viti 1981. Vazhdoi për Kulturën Masive (Degën e Librit) në Korçë, e kryen atë shkëlqyeshëm në vitin 1990. Pranë gazetës "Jehona e Skraparit" ka kryer kursin e gazetarisë. Nga viti 1978 deri më 1987, ai ka bashkëpunuar me Kabinetin e Gjuhësisë së rrethit Skrapar, (sektorin e leksikologjisë dhe leksikografisë).

Krijimtarinë e ka nisur që herët, qysh kur ishte nxënës në bankat e shkollës 8- vjeçare. Fillimisht ka botuar në revistat "Fatosi" e "Pionieri". Më vonë, prej vitit 1976 e deri sot, shkruan e boton në gjithë medien e shkruar dhe atë elektronike. Në vitin 1984, merr çmim të parë në festivalin kombëtar të këngës për fëmijë që u organizua në qytetin e Shkodrës; me titullin e këngës "Ligjëron nëna për djalin" të kompozuar nga Hajri Xhamëni. Po kështu, ka shkruar tekste këngësh folklorike. Kënga me motive të dasmës së krahinës së Skraparit "Moj nuse, faqe simite" merr çmimin e dytë në festivalin folklorik të Gjirokastrës.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Është autor i katër këngëve, që janë hedhur në disk të kënduara nga këngëtarët popullorë Asllan Ibro e Bajram Haxhillari, në vitin 2009 dhe 2013 - ën. Tekstet e këngëve iu kushtohen dëshmorëve të Vlushës (të vrarë në luftën e Dytë Botërore-1944); si dhe Astrit Suli, - Dëshmor i Kombit, i cili dha jetën për çlirimin e Kosovës në vitin 1999.

Në vitin 2009 merr pjesë në konkursin letrar për tregimin më të mirë të organizuar nga shtëpia botuese "Ada" dhe revista "Obelisk", ku tregimi me titull "Hijet e harresës" hyn në antologjinë "Tapeti i tregimit'' . Me poezinë "Nëna" merr pjesë në antologjinë "Lotët e Virgjër" me autor Agim Mato – Fatmir Terziu, botuar nga "APCO" 8 mars 2012 në Londër. Ku midis 143 poetëve nga gjithë trojet shqiptare është edhe emri i poetit Xhevahir Cirongu.Ka marrë pjesë me poezitë e tija të botuara në 10 antologjitë me poezi që ka botuar shtëpia botuese"Muzgu" në Tiranë. Po kështu, autori Xhevahir Cirongu është edhe redaktor e korrektor i mbi 70 librave .

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Poezitë e Xh.Cirongut janë vlerësuar edhe nga kritikë e studiues të ndryshëm. Të tillë janë Faik Xhani – Tiranë e Pjetër Cara – Durrës, i cili vlerëson poezitë te libri me titullin "Bisedë me poezinë" midis autorëve të tjerë edhe krijuesin e trevës së Skraparit, poetin nga Leskova e Tomorricës, Xhevahir Cirongu.Ka punuar në Kulturë e telekom deri në vitin 1990. sot shkruan në mediat e shkruara dhe ato elektronike në të gjitha fushat gazetareske e letrare. Deri tani është autor i 10 librave.

Ka në proces botimi edhe 4 të tjerë me tematikë të ndryshme. Deri më sot, publicisti, poeti e shkrimtari Xhevahir Cirongu, në fushën e gazetarisë ka botuar rreth 3000 mijë artikuj të fushave të ndryshme në publicistikë e letërsi.

Jo vetëm kaq, Xhevahiri është edhe një kritik e vlerësues i mirë letrar. Janë me dhjeta kritika vlerësuese që u ka bërë shumë autorëve rreth librave të tyre, në Shqipëri e Kosovë. Ai di të qëndis bukur fjalën e shkruar dhe të bëjë vlerësim real që mirëpritet nga lexuesi i mirëfilltë letrar.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Ka bashkëpunuar dhe është bashkëpunëtor i shumë gazetave e revistave brenda dhe jashtë vendit. Ka botuar e boton shkrime në revistat: "Fatosi’, "Pionieri", "Shqiptarja e re", "Hosteni", "Obelisk", "Dituria", "Metafora", "Vegime letrar" , ‘’Pavdekësia’’ ‘Krahu i shqiponjës’’ etj.
Por edhe në gazetat "Jehona e skraparit", "Luftëtari", "Puna", "Zëri i rinisë", "Bulevard", "E vërteta", "Ndryshe", "Zëri i popullit", "Republika", "Kushtrim brezash", "Telegraf", po edhe te "Drita", "Muzgu", "Dielli i Tomorrit", "Nacional", ‘’Dëshnica’’, ‘’Golloborda’’, ‘’Tirana observër ’’, ‘’Fryme e Re’’por gjithashtu tek ‘’Lajmi’’, ‘’Bota sot’’ në Kosovë, etj. *Në vitin 1986 vlerësohet me Medalien ‘’Naim Frashëri’’ . Gjithashtu, Xhevahiri merr pjesë në ‘’Ditët Naimiane’’ që organizohet për çdo vit në Përmet, i cili përfshihet me një poezi në këtë antologji.*

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Korospodent i radios Zëri i Arbërit në Norvegji për emisionin Çamëria. Xhevahiri është bashkëpuntor në shumë portale elektronike, ku ai shkruan e pasqyron të gjitha gjinitë gazetareske e letrare brenda dhe jashtë vendit.

Eshtë antar i Klubit të Shkrimtarëve e Artistëve - Durrës.

Botime të autorit:

1.Kush ia shkeli syrin Ildës, poezi (2005)

2.Tomorrica zemra jonë (bashkëautor) ,monografi (2009)

3.Shpirtit i thërres, poezi (2009)

4.Mall nga oqeani, publicistik, poezi, tregime (2010)

5.Misteri i një graje, tregime (2010)

6.Bisqet e gjakut, monografi histori (2013)

7.Kosmogonia e një poeti kosovar (bashkëautor) përmbledhje kritika vlerësuese letrare (2014)

8. Tomorri qiell perëndie, publicistikë (2015)

9. Pena e Bedri Tahirit përjetëson lavdinë tonë kombëtare , histori (Bashkautor) (2015)

10. Kënga e lotit, poezi (2016)

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Përmbajtja

faqe

Në rrugicën e lagjes..... 9
Letër nënës..... 10
Shi në qytetin tim..... 11
I putha gjethet e vjeshtës..... 12
Unë flas me plepin..... 14
Poetit Adem Zaplluzha..... 15
Emri yt flamur mbi re..... 16
Puthjet e gjyshes ylberedrite..... 20
Pengu i lotit..... 22
Në folenë e dritës hënë..... 23
Në udhëkryqe semaforët ndezur..... 25
Kënga e lotit..... 27
Kush tha se vdes dashuria..... 28
Sytë e kaltërsive..... 30
Fyelli i çobanit..... 31
Shi vjeshte..... 32
Rritet një pulbardhë..... 33
Alfabeti i gjuhës shqipe..... 34
E bukur kënga Çame..... 35
Fjalët e planetit..... 36

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

Mall i zhuritur..... 37
Kthehu..... 38
Nën tinguj takash..... 39
O baba Tahir të erdha..... 40
Bisedë me detin..... 41
Shpirti më foli..... 43
Bukuri paska kjo jetë..... 44
Kur trokasin stinët..... 46
Fluturo o ëndrra ime..... 47
Lule çelur Durrësi im..... 48
Një çast takimi..... 49
Muzgjeve të mbrëmjeve..... 50
Poet i pathyeshëm..... 52
Emrin e ka nënë.....54
Zenun Gjocaj o burrë stralli..... 55
Nostalgjia e pikave të shiut..... 59
Lot i argjend..... 60
Fletëza urimi të bardha bore..... 61
Lotdhimbje nëntori..... 64
Fshati tim të lindjes..... 65
Peneli i piktorit..... 66
Asllan Ademit- Prishtinë..... 68
Ulliri që puthë hënën..... 69
Sytë e kaltërsive..... 70
Loti i nënës..... 71
Shqiponjat Arbërore..... 73
Kitara mbi barakë..... .75

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT

O moj Vlusha heroike..... ..77
I shtrenjti atdhe..... 79
Vajzës me emrin Erta..... 81
Puthje në mermer të bardhë..... 83
Dialog te guri i vetëmisë..... 85
Kohëthyera ëndërr..... 87
Nesër baladë do mbetesh..... 89
Vallëzo me yjet..... 91
Guri i syrit të vesës..... 93
Pentagrami i stinëve..... 95
Më e shtrenjta fjalë..... 96
Ndaloni një çastë..... 97
Vargu i poetit t'u bë kurorë..... 99
Ditëlindja e vajzës sime..... 102
Shtegtimi i poetëve..... 103
Lot me pikgjaku..... 104
Rrënja e dashurisë..... 105
Kujtim i vjetër..... 106
Plisi bardhë-këngë lirie.....107
Çamëri, gonxhe e dhimbjes.....111
Dikur këndohej kënga e jetës.....113
Lulet e blirit.....116

Fund - Prill 2016.

XHEVAHIR CIRONGU- KËNGË LOTIT